



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AAC kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Autoriteti i Aviacioni Civil (AAC) gjatë vitit 2024 ka shpenzuar 92% të buxhetit final, në vlerë prej 708,064€. Mangësitë e identifikuara kishin të bëjnë me vonesën e trajtimit të aplikimit për shërbime në tokë dhe mangësive në menaxhimin e sistemit e-pasuria.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Po ashtu, ne si ekip kemi dhënë këshilla për përmirësimin e draft pasqyrave financiare vjetore të AAC-së për vitin 2024, të cilat pas rekomandimeve tona, janë përmirësuar.

Ky raport ka rezultuar me 2 (dy) rekomandime, 1 (një) rekomandim është i ri si dhe 1 (një) rekomandim është i përsëritur nga viti i kaluar. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga AAC në vitin 2024 ishin në vlerë 3,861,544€. Ato kanë të bëjnë me taksën e sigurisë së udhëtarëve dhe taksa/tarifa tjera të vendosura nga AAC-ja, p.sh. tarifat për licenca të ofrimit të shërbimeve etj.

Çështja A1 - Vonesë në trajtimin e kërkesës së OE për aplikim në ofrimin e shërbimeve në tokë

Gjetja

Sipas rregullores Nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, Neni 7 pika 7.1 AAC-ja do të ndërmarr hapat e nevojshëm në pajtueshmëri me aranzhimet e përcaktuara për t'iu siguruar qasje të lirë në treg furnizuesve që të ofrojnë shërbime në tokë për palët e treta. Tuje, Neni 12 Zgjedhja e furnizuesve, AAC-ja do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për organizimin e procedurës së zgjedhjes së furnizuesve të autorizuar për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë. Po ashtu, në dokumentin zyrtar AACK/AGA-PC 08, Hapi 15 specifikohet: “Njoftimi për refuzim të aprovimit duhet t'i dërgohet aplikuesit me shkrim për refuzimin apo aprovimin brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data e aplikimit zyrtar.”

Gjatë testimit të të hyrave nga “Tarifa për aplikimin e operatorit ekonomik për aprovim fillestar për ofrimin e shërbimeve në tokë”, në vlerë prej 2,500€, të arkëtuara më 08.07.2024, kemi vërejtur se Operatori Ekonomik (OE) kishte dorëzuar aplikimin zyrtar në AAC për të marrë miratimin si furnizues i shërbimeve në tokë për palë të treta, në kategorinë “Shërbime me derivate dhe vajra”, që përfshijnë operacionet e furnizimit, deponimit, kontrollit të cilësisë dhe sasisë së derivateve.

Pas kësaj, në raportin vlerësues të hartuar nga departamenti përgjegjës në gusht 2024, u konstatua se OE kishte përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, me përjashtim të mungesës së dëshmimeve për planin e trajnimit dhe certifikatat e kompetencës së stafit siç kërkohet për këto shërbime me rregullore.

Për këtë çështje, me datë 20.01.2025 Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së mori vendim se aplikuesi i përmbush pjesërisht kriteret. Vendimi citon po ashtu që pas përmbushjes në tërësi të kërkesave tjera, AAC mund të lëshojë aprovimin përkatës.

Sipas informatave zyrtare, OE ka kërkuar takim me palët përgjegjëse për këtë çështje, mirëpo deri në përfundimin e auditimit, nuk kemi vërejtur që është ndërmarrë ndonjë veprim për të proceduar tutje drejt aprovimit apo refuzimit të tij, për shkak të mos lejimit të qasjes nga aeroporti.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së një mekanizmi funksional për ndjekjen e afateve të vendimmarrjes.

Ndikimi

Vonesa në trajtimin e kërkesës së OE për aplikim në ofrimin e shërbimeve në tokë si dhe mos dhënia e qasjes nga aeroporti mund të ndikojë në një proces jo të drejtë dhe jo transparent për trajtimin e aplikimeve, duke penguar konkurrencën në tregun e shërbimeve në tokë.

Rekomandimi A1 Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë që janë shqyrtuar kërkesat e aplikuesve brenda afateve të përcaktuara si dhe të sigurojë koordinim të përgjegjësive institucionale në çdo fazë të procesit të aprovimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 10,839€, pasurive jokapitale është 16,746€, si dhe vlera e stoqeve 3,713€.

Çështja C1 - Mos regjistrimi i pasurive jokapitale në sistemin e-pasuria

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 specifikon se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Pavarësisht rekomandimit nga viti i kaluar, AAC ende nuk ka arritur të funksionalizojë plotësisht sistemin e-pasuria, për shkak të mos regjistrimit të pasurive jokapitale në sistem, edhe pse që gjatë vitit ka bërë regjistrimin dhe mirëmbajtjen e stoqeve në këtë sistem. Në mungesë të regjistrimit të pasurive jokapitale në sistem, AAC kishte evidentuar pasuritë jokapitale në listat e brendshme në formën e Excel-it dhe të njëjtat i kishte shpalosur në PFV.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i problemeve teknike të cilat i kishin hasur zyrtarët e AAC-së gjatë përpjekjeve për të regjistruar pasuritë jokapitale në sistemin e-pasuria.

Ndikimi Mirëmbajtja manuale e të dhënave për pasuritë jokapitale rrit mundësinë e gabimeve gjatë përditësimit të regjistrave, shlyerjeve të tyre, keqpërdorim, humbje apo tjetërsim të mundshëm të tyre.

Rekomandimi C1 Drejtori i përgjithshëm duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar plotësisht sistemin e-pasuria, duke mundësuar që pasuritë jo kapitale të evidentohen dhe të mirëmbahen në këtë sistem, dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	687,168	772,822	708,064	739,945	750,068
Grante Qeveritare - Buxheti	687,168	766,894	708,064	739,945	750,068
Donacionet e jashtme	0	5,928	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 85,854€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë, për mbulimin e shpenzimeve të pagave për muajt Nëntor dhe Dhjetor.

Në vitin 2024, AAC ka shpenzuar rreth 92% të buxhetit përfundimtar ose 708,064€, me një rritje prej 1% krahasuar me vitin 2023. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	687,168	772,822	708,064	739,945	750,068
Pagat dhe mëditjet	535,213	614,939	614,939	650,395	693,109
Mallrat dhe shërbimet	128,217	134,145	88,758	88,958	56,377
Komunalitë	3,738	3,738	369	591	582
Investimet Kapitale	20,000	20,000	3,999	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 79,726€, si rezultat i vendimit të Qeverisë Nr. 22/233 me datë 27.11.2024 dhe 03/239 me datë 24.12.2024. Këto mjete janë ndarë për mbulimin e shpenzimeve të pagave për muajt Nëntor dhe Dhjetor. Buxheti final ishte realizuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,928€. Në këtë kategori buxheti ishte shpenzuar 66%. Në vlerën e ultë të shpenzimit kanë ndikuar anulimet e disa trajnimeve të planifikuara si dhe vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë më të ulët sesa që ishin planifikuar;
- Buxheti final për shpenzimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte i njëjtë. Realizimi i shpenzimeve ishte në vlerë 368€ apo 10%. Pothuaj, vlera e njëjtë e shpenzimeve ishte edhe vitin paraprak që kanë të bëjnë me shpenzimet e telefonisë fikse, përderisa të tjerat mbulohej MAP/MPB; si dhe
- Buxheti final i investimeve kapitale nuk kishte ndryshime me atë fillestar, mirëpo shpenzimi ishte i ulët apo 20% e buxhetit final. Arsyeja e shpenzimit të ulët ishte mos realizimi i projektit kapital “Softuer për dizajnin e sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesa e aerodromeve për nevojat e AAC-së”, realizimi i të cilit ka kaluar në vitin 2025.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga AAC në vitin 2024 ishin në vlerë 3,861,544€. Ato kanë të bëjnë me taksën e sigurisë së udhëtarëve dhe taksat/tarifat tjera të vendosura nga AAC-ja, p.sh. tarifatat për licenca të ofrimit të shërbimeve etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	5,101,166	5,101,166	3,861,544	3,344,034	2,899,912
Të hyrat jo tatimore	5,101,166	5,101,166	3,861,544	3,344,034	2,899,912

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të AAC ka rezultuar me një (1) rekomandim kryesor. AAC kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimi dhe dhënë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, ky rekomandim është zbatuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë, që zyrtarët përgjegjës të bëjnë regjistrimin e pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria.	Këtë vit janë ndërmarrë veprime për përmirësim, por megjithatë mbetet rekomandim i pjesërisht i zbatuar, pasi pasuria jokapitale ende nuk ishte regjistruar në sistemin E-pasuria. Shih çështjen C1.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
PRITJE KOMBËTORE UDHËHEQËS I KONTABILITETIT			
Nr. Prot. 10-2025			
Nr. Org.	Shit. Klasif.	Nr. Prot.	Nr. Udhëheq.
05	47	986	1
Org. Jeshit	Klasif. Kod	Prot. No.	Dir. Çështje
	Class. Code	No. Prot.	No. Cases

República e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			
Auditorët e Kosovës / Auditores de Kosovo / Auditors of Kosovo			
CAA			
Nr. i prot. 2025/ZDP/240			
Sipërfaqe			
Faqe: 1	Pagja: /	Data: 17.06.2025	
Strukturat		Edukimi	
Mjete/Tools		Edukimi/Training	
Dokumentet		Edukimi/Training	
Bazat e të dhënave		Edukimi/Training	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
Autorität e Luftëtarëve Ndërkombëtarë të Kosovës
Civil Aviation Authority of Kosovo

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Matej Krasniqi,

UD, i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës

Data: 17/06/2025, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.